



Funded by
the European Union



Funded by
the European Union

Shoqata e personave me aftësi të kufizuar- Handikos Ferizaj është OJQ e themeluar nga dhe për Personat me Aftësi të Kufizuar, me qëllim për të përkrahur angazhimin e tyre në shoqëri.

VIZIONI

Shoqëri gjithëpërfshirëse me njohje dhe realizim të plotë të, të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave

MISIONI

Handikos Ferizaj është organizatë joqeveritare që punon në rritjen e mirëqenies dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, përmes avokimit dhe ofrimit të shërbimeve sociale.



Rruga Zenun Beqa, 70000 Ferizaj

E-mail: handikosferizaj@gmail.com

www.handikos-ferizaj.org

Ofrimi i shërbimeve me bazë në shtëpi për personat me aftësi të kufizuar kanë për qëllim përmirësimin e jetës dhe mirëqenien e personave me aftësi të kufizuara duke lehtësuar përditshmërinë e tyre dhe duke ndihmuar që të fitojnë më shumë autonomi dhe pjesëmarrje në jetën sociale dhe atë në komunitet.

Ofrimi i Shërbimeve me bazë në Shtëpi



Kjo broshurë është zhvilluar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj mbetet përgjegjësi e Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara – Handikos Ferizaj dhe jo-domosdoshmërisht e reflekton qëndrimin/pikëpamjet e Bashkimi Evropian apo Save the Children.

Shërbimet që ofrohen gjatë vizitave në shtëpi

Asistencë në shtëpi ka për qëllim të modifikojë mjedisin e personave me aftësi të kufizuara për ta bërë atë sa më të qasshëm përmes trajnimit të tyre në vetë kujdesin dhe aktivitetet ditore lëvizëse të tilla si:

- Ushtrimet lëvizëse;
- Kujdesi personal;
- Pastrimi, gatimi, larja e rrobave, hekurosja;
- Përkujdesja e inkontinencës;
- Këshillim rreth përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve ndihmëse.

Mbështetje për jetesë të pavarur

Ky shërbim i referohet ofrimit të këshillave për mbështetje dhe integrim në shoqëri për personat me aftësi të kufizuara më fokus kryesor në:

- Jetesë të pavarur;
- Krijimin e mundësive (inkurajimi për takime sociale, seminare, trajnime);

Mbështetja psikologjike/ Këshillimi

Me anë të mbështetjes psikologjike / këshillimit ofrohen shërbime të cilat adresojnë nevojat psikologjike dhe sociale të personave me aftësi të kufizuara dhe prindërve / familjarëve të tyre.

Gjatë këtij shërbimi përfshihet:

- Zhvillimi i aftësive sociale dhe miqësive;
- Ndërtimi i marrëdhënieve me familjen;
- Qëndrimi i mirë fizikisht përfshirë edhe ushtrimet;
- Ndërtimi i aftësive të jetesës përfshirë këtu edhe besimin dhe qëndrueshmërinë.

Këshillimi grupor

Ndihmon anëtarët e familjes të përmirësojnë komunikimin dhe të zgjidhin konfliktet duke shprehur ndjenjat e tyre dhe problemet në familje. Gjithë kjo kontribuon në krijimin e marrëdhënieve të sigurta dhe mbështetëse ndërmjet tyre.

Këshillim/mbështetje infermierike

Shërbimet e infermierisë i referohen ofrimit të kujdesit primar shëndetësor në parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dytësore duke ndihmuar personat me aftësi të kufizuara të bëjnë jetë aktive dhe të shëndetshme në komunitetet e tyre.

Në këshillim/mbështetje infermierike përfshihet:

- Këshilla në trajtime mjekësore;
- Këshilla dhe vetë-kujdesi;
- Ushtrimet fizike;
- Trajtimi i plagëve dekubitare;
- Ndërtimi i kateterit;
- Matja e shtypjes së gjakut, koncentrimi i sheqerit në gjak, etj;

Aktivitetet kreative

Aktivitetet kreative kanë për synim përmirësimin e jetës dhe mirëqenies së personave me aftësi të kufizuara duke rritur vetëvlerësimin, zhvillimin e aftësive sociale dhe integrimin e tyre në komunitet.

Aktivitetet sociale dhe rekreative

Këto lloje të aktiviteteve përfshijnë takime çdo dy javë për të gjithë përfituesit. Ato realizohen në formë të shëtitjeve, vizitave nëpër muze, galeri, etj. Përmes tyre mundësohet që personat me aftësi të kufizuara të jenë më aktivë, ndikojnë pozitivisht në humorin e tyre dhe rrisin nivelin e tyre të pavarësisë.

